

VENDIM
Nr.637, datë 24.12.1999

PËR NJË SHITESË NË FONDET BUXHETORE TË DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË TATIMEVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 21, të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998, “Për hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit të Republikës së Shqipërisë”, dhe të ligjit nr.8339, datë 29.12.1998 “Për buxhetin e shtetit të vitit 1999” me propozimin e Ministrisë së Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1.Drejtoria e Përgjithshme të Tatimeve, i shtohet fondi i pagave në shumën prej 95 milionë lekësh, i cili do të përdoret si fond i veçantë për shpërblimin e punonjësve në shkallë vendi, deri në tre paga mujore.

2.Efektet financiare të përballohen nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

3.Ngarkohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta